



Kompania Rajonale e Ujësjesit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

KRU."GJAKOVA" SHA, Gjakovë			
Marre në datën: 03.05.2023			
Njësia org.	Numri	Titujca	Vlera
	882		

Bordi i Drejtoresve i KRU "Gjakova" SHA bazuar në kompetencat komfor nenit 7 paragrafi 2 i Statutit të KRU "Gjakova" Sh.A. si dhe kërkesat që dalin nga Ligji i Punës Nr. 03/L-212 , Udhëzimit Administrativ Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik 07/2017, si dhe Neni 34 i Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike në mbledhjen e mbajtur me datë 02.05.2023 aprovoi këtë:

RREGULLORE Nr. 882 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES NR. 862 /2023 PËR ORGANIZIMIN DHE SISTEMATIZIMIN E
VENDEVE TË PUNES NË KRU " GJAKOVA" SH.A. -GJAKOVË

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores nr.862 / 2023 Për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në K.R.U."Gjakova" Sh.A.

Neni 2

Neni 8 pasuesi i tretë riformulohet si vijon : Në procedurën e plotësimit të vendit të punës përmes konkursit , përgatitjes shkollore profesionale që më së shumti i përshtatet detyrave të punës, i bëhet vlerësimi maksimal i pikëve .

Shtohet pasuesi i katër si vijon : Me organizim dhe sistematizim të ri të punës , i punësuarit sistemohet në vend të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij të punës , në pajtim me Ligjin e Punës , Udhëzimit Administrativ Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik 07/2017 si dhe kushtet dhe kriteret e përcaktuara për pozitën me këtë Rregullore .

Neni 3

Neni 27 , riformulohet me tekstin si vijon : Punëtorët të cilët ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje janë gjetur në kryerjen e punës dhe detyrave të punës për të cilët kërkohet shkallë më e lartë e përgatitjes profesionale se sa atë që disponojnë - niveli master i shkollimit , mund të sistemohet sërish në atë pozicion pune për kohë të caktuar , me

kusht që i punësuari me shpenzimet e veta të vazhdon të kualifikohet për atë vend pune në afat kohor prej 2 vite. Në funde të çdo viti i punësuari obligohet të sjellë dëshmi - vërtetimin mbi kryerjen e vitit të shkollimit, kriter që do kërkohet për vazhdim të kontratës , në të kundërtën i punësuari do të sistemohet në vend tjetër të punës që do i përshtaten ngritjes profesionale.

Neni 4

Plotësohet Rregullorja Mbi Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Përshkrimin e tyre në pozicionet :

Pozita - Zyrtar Certifikues

Kushtet e veçanta : Hiqet kontabilist i certifikuar

Zyrtar/e për BNJ

Numri i kryeseve: 2

Neni 5

Dispozitat kalimtare

Me këtë Rregullore bëhet ndryshimi plotësimi e rregullores përkatëse ,për tu harmonizuar me plotësimet e përdorura në këtë Rregullore .

Neni 6

Kjo Rregullore hynë në fuqi menjëherë pas aprovimit nga Bordi i Drejtorëve të KRU"Jakova" SH.A. -Gjakovë.

Datë : 02.05.2023
Gjakovë

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

Urim Gashi

